



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Planuar - Prindjora Mbretëria **25-05-2016**

Nr./ organit Org. broj	Nutritje	Ehtojcë Prirog	Vlera Vradnost
01-013/041			



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12. paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, Instruksionit për Rishikim të buxhetit për vitin 2016 të datës 13.05.2016 i protokoluar më datë 16.05.2016 nr 01/973 të lëshuar nga Ministri i Financave , dhe nenit 36. paragrafi 36.2 shkronja d) të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seance e mbajtur më 24.05.2016, aprovon këtë:

V E N D I M PËR RISHIKIMIN E BUXHETIT KOMUNAL PËR VITIN 2016

Neni 1.

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë lejon RIDESTINIMIN e mjeteve mes projekteve në të njëjtën kategori ekonomike të investimeve kapitale në shumë prej 100.000 € duke u bartur mjetet prej projektit „ Ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Pozheran “ në projektin „ Participim i projekteve me donator “ pa e ndryshuar totalin e buxhetit dhe programin .

Fondi burimor 10

Kategoria ekonomike investime kapitale të barten mjetet mes projekteve (shuma 100,000)
Programi Buxhet e financa (175), nënprogrami Buxhetimi (17533)

Nga projekti:

Ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Pozheran kod i projektit 44156 shuma prej - 100,000

Në projektin:

Participim i projekteve me donator kod i projektit 90552 shuma prej 100,000

Neni 2.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Vitisë.

Neni 3.

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në Veb faqen e Komunës së Vitisë.

KRYESUESI I KUVENDIT

Naim Pira

